

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ADN Media Shpk.

NENI 1

KRIJIMI DHE EMRI

1.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **ADN Media Shpk** . (ne vijim e quajtur "**Shoqeria**") themelohet sot ne dt. 30/01/2024 ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

1.2 Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Tirane, Shqiperi.

NENI 2

SELIA

2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Dervish Hima, Nr. 1, K. 1, Tirane, Shqiperi.

2.2 Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojte filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI

3.1 Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here.

3.2 Aktiviteti i Shoqerise do te konsistoje kryesisht ne:

1. Botimin dhe shperndarjen e gazetave "Albanian Daily News", nepermjet mjeteve te ndryshme te komunikimit, si gazeta te printuara apo online. Publikimi i gazetave. Portal Web.
2. Botimin dhe shperndarjen e gazetave te tjera nepermjet mjeteve te ndryshme te komunikimit, si gazeta te printuara apo online.
3. Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet e tjera tregtare, industriale, te luajtshme, te paluajtshme si edhe financiare (kjo e fundit gjithsesi jo ne nje forme mbizoteruese dhe jo per publikun) qe do te konsiderohen te nevojshme vetem per qellimin e arritjeve te objektit te Shoqerise si me siper, duke perfshire dhenien e dorezanive dhe garancive, perfshire ato te paluajtshme, kundrejt çdokujt per te garantuar detyrimet edhe te nje pale te trete.

NENI 4

KOHEZGJATJA

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

NENI 5

KAPITALI

5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 1.000 Leke (*nje mije*). Kapitali eshte i ndare ne 2 kuota qe zoterohen si me poshte:

- 1 kuote me vlere 510 Leke qe perfaqeson 51% te kapitalit te Shoqerise zoterohet nga Znj. Anisa Skendaj;
- 1 kuote me vlere 490 Leke qe perfaqeson 49% te kapitalit te Shoqerise zoterohet nga Z. Julien Roche.

Kuotat jane nenshkruar teresisht nga Ortaket e siperpermendur dhe do te paguhen sipas kerkeses se administratorit te Shoqerise.

Pergjegjësia e Ortakeve per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 5

ORTAKET

5.1 Hyrja ne Shoqeri e ortakeve te rinj si pasoje e trashegimise ose transferimit te kuotave tek pale te treta apo ne nje menyre tjeter, do te behet ne perputhje me kete Statut, por nuk do te perbeje nje ndryshim te tij. Çdo ndryshim ne ortakerine e Shoqerise do te vendoset nga asambleja e pergjithshme e ortakeve.

5.2 Adresa e ortakeve per efekt te marredhenieve te tyre me Shoqerine, eshte ajo qe rezulton nga regjistri i ortakeve. Eshte detyrim i ortakeve te njoftojne ndryshimin e adreses se tyre. Administratori/et ka/ne per detyre te mbaje/ne dhe perditesoje/ne kete regjister.

5.3 Dispozitat e ketij neni te Statutit kane per qellim mbrojtjen e interesave te Shoqerise, unitetit te ortakeve dhe ekuilibrit te marredhenieve midis tyre dhe per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme, ne rastin e transferimit te kuotave:

- Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve me njeri-tjetrin.
- Ne rast te transferimit te çdo forme te kuotave (perfshire dhe trasferimin pa kundershperblim), tek subjekte te ndryshem nga ata te percaktuar me lart, transferimi do te kushtezohet nga ushtrimi i se drejtes se parablerjes nga ortakët e tjere te Shoqerise, mbi kuotat te cilat do te transferohen.

NENI 6

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

6.1 **Organi vendimmarres.** Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithe ortakët dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortakët, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim apo qe kane votuar kunder ketyre vendimeve.

6.2 **Llojet e vendimeve.** Asambleja e Ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te vendose, ne nje mbledhje, fizikisht ose nepermjet mjeteve alternative te komunikimit, ose nepermjet konsultimit me shkrim, per çeshtjet e meposhtme, por pa u kufizuar ne to:

- percaktimin e politikave tregtare dhe investimeve;
- ndryshimin e ketij Statuti;
- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqeri te tjera;
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- emerimin dhe shkarkimin e administratorit(eve);
- emerimin e ekspertit(eve) kontabel te autorizuar;
- percaktimin e shperblimit te administratorit/eve, likuidatorit/eve dhe ekspertit/eve kontabel te autorizuar;
- mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit(eve), perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqrave financiare dhe raporteve te aktivitetit;
- miratimin e raportit te administratorit/eve dhe te pasqrave financiare;
- shperndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- likuidimin e Shoqerise dhe emerimin e likuidatorit/eve;
- miratimin e barreve/pengjeve mbi kuotat e Shoqerise;
- çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji ose nga Statuti.

6.3 Thirrja e asamblese



- Asambleja e pergjithshme e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit te ecurise se veprimtarise te Shoqerise si dhe kur kjo kerkohet me shkrim nga nje ose disa ortake qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Ne rastin e fundit nese Administratori nuk e therrret asamblene brenda 15 (pesembedhjete) ditesh nga paraqitja e kerkeses se ortakeve, keta te fundit kane te drejte ta therrresin vete asamblene e pergjithshme te ortakeve, duke percaktuar rendin e dites, kohen dhe vendin e takimit ne perputhje me procedurat e percaktuara ne dispozitat ne vijim.
- Asambleja e pergjithshme e ortakeve mblidhet edhe ne rastet e kerkuara nga ligji apo kur shihet e nevojshme nga secili administrator.
- Asambleja e pergjithshme e ortakeve mblidhet ne seline ligjore apo prane nje vendi tjetër brenda ose jashte Shqiperise.
- Mbledhja e asamblese se pergjithshme te ortakeve thirret me ane te nje njoftimi me shkrim te derguar me poste rekomande ose nepermjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve. Njoftimi duhet te tregojë rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe do t'i dergohet secilit ortak, jo me vonë se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Gjithashtu, njoftimi duhet te permbaje, edhe menyren e pjesemarrjes ne asamblene e ortakeve dhe/ose menyren e vendimmarrjes. Njoftimi i mbledhjes mund te parashikojë edhe nje date te dyte per mbledhjen e asamblese ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet sipas njoftimit. Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet nepermjet postes elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marre nga ortakët ne daten/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te njoftimit te postes elektronike. Mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve dhe vendimet e saj jane te vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjese te gjithë ortakët qe perfaqesojne te gjithë kapitalin e Shoqerise.

6.4 Mbajtja e mbledhjes

- Asambleja e pergjithshme e ortakeve kryesohet nga personi i emeruar nga shumica e ortakeve pjesemarrës ("Kryetari i Mbledhjes"). Kryetari i Mbledhjes emerohet sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes se asamblese.
- Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese nepermjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunimit video-shkrues. Perdorimi i mjeteve elektronike do te kryhet duke marre te gjitha masat teknike te nevojshme per garantimin e identifikimit te ortakeve, si edhe sigurine e ketyre mjeteve elektronike. Ne veçanti eshte e nevojshme qe:
 - i. Kryetari i Mbledhjes te kete mundesine te verifikojë dhe te identifikojë ortakët te cilet jane te pranishem, te kontrollojë mbarevajtjen e mbledhjes, te numerojë dhe te shpallë rezultatin e votimit;
 - ii. Sekretari dhe/ose mbajtësi i procesverbalit te kete mundesine per t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura ne mbledhjen, objekt te procesverbalit;
 - iii. Te mundesohet pjesemarrja e te gjithë te pranishmeve per te diskutuar mbi rendin e dites, ne shqyrtimin, marrjen dhe shperndarjen e te gjitha dokumentave te perdorura gjate mbledhjes si dhe ne procesin e votimit mbi rendin e dites.
- Mbledhja e asamblese ne kushtet e permendura me lart konsiderohet rregullisht e mbajtur ne vendin ku eshte i pranishem Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtësi i procesverbalit, i cili ben te mundur pergatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes. Kryetari i Mbledhjes do te verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesemarrës ose perfaqesuesve te tyre.
- Ne rast se ortakët jane te ftuar te marrin vendime nepermjet konsultimit me shkrim, kuorumi do te quhet si i formuar bazuar ne numrin e ortakeve qe do te dergojne voten dhe vendimet e tyre me shkrim. Çdo administrator ose Ortaku qe kerkon vendimarrjen duhet t'i dergojne çdo ortak njoftimin per konsultimin me shkrim, i cili do te permbaje gjithë informacionet qe perfshihen ne letren e njoftimit/thirrjes. Procedura e konsultimit me shkrim duhet te kryhet ne perputhje me permbajtjen e ketij neni, ne rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet te shprehet me shkrim ne lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve ne formen e derguar nga Administratori/et, nepermjet shenimit "pro" ose "kunder" ose duke shprehur komentet e tyre ne nje dokument tjetër. Ne rastin kur ortakët kane komente, duhet t'u bejne reference te qarte projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dergojë Administratorit ose Ortakeve qe kane kerkuar

marrjen e vendimit nepermjet keshillimit me shkrim, voten e tij/vendimet me shkrim brenda dates se percaktuar ne njoftimin e derguar per marrjen e vendimin nepermjet konsultimit me shkrim.

- Vendimet e marra te ortakeve si dhe diskutimet dhe komentet e ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes te hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet te pasqyroje menyren e organizimit te mbledhjes se asamblese apo te konsultimit me shkrim nese eshte kryer ne perputhje me ligjin dhe dispozitat e Statutit, te identifikojte ortaket e pranishem dhe te perfaqesuar ose ortaket qe kane votuar me shkrim, nese kuorumi i ortakeve qe kane votuar me shkrim eshte respektuar sipas Statutit dhe Ligjit Tregtar, si dhe nese vendimet konsiderohen te miratuara sipas votave te marra. Procesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbalit i bashkengjitet gjithashtu lista e ortakeve qe kane votuar (pervec rastit kur procesverbali eshte nenshkruar nga gjithe ortaket) dhe do te mbahet ne seline e Shoqerise. Nese vendimet e marra nga ortaket duhet te depozitohen prane Regjistrimit Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhena (nepermjet konsultimit me shkrim nga ortaket) apo vendimet e asamblese do te sherbejne si dokumentet qe provojne te dhenat qe do te depozitohen ne kete regjister.
- Ne rast se asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk mund te shqyrtoje ne te njejten dite te gjitha ceshtjet qe duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do te behet te nesermen pa pasur nevojte per njoftim te metejshem.

6.5 Kuorumi dhe shumica. Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamblene e pergjithshme dhe te votoje ne perjestim me kontributin e tij. Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme nga nje ortak tjetere apo nje person i trete te autorizuar nepermjet prokures me shkrim. Quorumi dhe shumica e percaktuar ne ligj do te zbatohet per te gjitha vendimet e Shoqerise. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuoromit, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 (tridhjetete) dite, me te njejtin rend dite dhe vendoset me kuorumin qe eshte i pranishem.

NENI 7

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

7.1 Pasuria, veprimtaria dhe aktiviteti i Shoqerise do te administrohet nga nje administrator i emeruar dhe caktuar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, per nje afat 5 vjeçar nga data e ketij akti.

7.2 Administratori i shoqerise eshte Znj. Anisa Skendaj, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me date 17.12.1984, per nje mandat 5 vjecar nga momenti i regjistrimit te Shoqerise, te rinovueshem.

7.3 Administratori do te ushtroje kompetencat e tij perkatese deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:

- largimi i tij; ose
- verifikimi i ngjarjeve te percaktuara ne kete Statut te Shoqerise; ose
- perfundimi i afatit 5 vjeçar, nese mandati nuk eshte rinovuar.

7.4 Administratori ka kompetenca te plota per te marre vendime per administrimin e zakonshem te Shoqerise, pervec kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit te zbatueshem. Administratori do te kete keto kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise sipas parashikimeve te Ligjit.

7.5 Administratori i Shoqerise mund t'i transferoje çdo personi apo grupi personash te gjithe apo nje pjese te kompetencave te tij sipas ketij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si te arsyeshme dhe ne çdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

NENI 8

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Eksperti(et) kontabel i (te) autorizuar do te emerohet(n) me vendim te asamblese se Ortakeve, ne çdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar.

NENI 9

VITI USHTRIMOR

9.1 Viti ushtrimor i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

9.2 Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

NENI 10

LIKUIDIMI

Likuidimi e Shoqerise si dhe emerimi i likuidatorit(eve) behet ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër te zbatueshem.

NENI 11

LIGJI I ZBATUESHEM

11.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me legjislacionin shqiptar.

11.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

11.3 Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 12

NDRYSHIMET

12.1 Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet ose shfuqizohet,ose te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me quorumin dhe shumicen e percaktuar ne kete akt sa kohe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

12.2 Ky Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje origjinale

ORTAKET



Anisa Skendaj



Julien Roche